



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Korrik
2025

Shërbimi Social Shtetëror, me mbështetjen e Programit Italo-Shqiptar të Konvertimit të Borxhit (IADSA) po zbaton në partneritet me Qendrën ASET, Regione Marche dhe Liguria projektin “EldEarly – Përmirësimi i Sistemit të Kujdesit ndaj të Moshuarve në Shqipëri”, që synon forcimin e mbështetjes për të moshuarit në vendin tonë.

Në kuadër të këtij projekti është ngritur një Linjë Këshillimi falas që ofron:

- Këshillim psikologjik për të moshuarit
- Referim për kujdes të shtuar shëndetësor e social

Telefononi falas në numrin 0800 4042. Linja është e hapur për të gjithë të moshuarit që kanë nevojë për mbështetje sepse çdo i moshuar ka të drejtë të ndihet i sigurt, i dëgjuar dhe i përfshirë.



An advertisement for the EldEarly project. The top half features an elderly woman with glasses smiling while talking on a black mobile phone. Text in the top left corner reads: "LINJA E GJELBËR PËR TË MOSHUARIT ËSHTË KËTU PËR TY!". Below this, a green speech bubble contains the text: "ÇDO TELEFONATË, NJË PËRQAFIM!". The bottom half shows a woman with curly hair wearing a headset, smiling. A green speech bubble next to her says: "TI NUK JE VETËM! TELEFONO FALAS NE NUMRIN 0800 40 42 LINJA E GJELBËRT PËR TË MOSHUARIT!". At the bottom, there are logos for "SHËRBIMI SOCIAL", "ASET", "REGIONE LIGURIA", and "REGIONE MARCHE".

Gjatë muajit korrik 2025, Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, nën kujdesin e Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, organizoi një kamp veror për fëmijët që ndodhen në institucion.

Kampi u zhvillua në ambientet e pishinave, ku fëmijët patën mundësi të kalojnë ditë të këndshme mes lojërave, aktiviteteve në ujë dhe pushimit aktiv. Këto ditë verore jo vetëm që i kanë ofruar fëmijëve çaste gëzimi dhe argëtimi, por gjithashtu kanë ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit dhe ndjenjës së komunitetit mes tyre.

Në këto ditë të nxehta vere, të rinjtë e Shtëpisë Familje 16-18 vjeç morën pjesë në një kamp veror të organizuar në bashkëpunim me *Malteser Albania*, në bregdetin e Velipojës.

Ky kamp u ofroi atyre mundësinë të pushonin, të shijonin detin dhe natyrën, por edhe të forconin shoqërinë dhe ndërveprimin mes tyre.



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Ndërgjegjësimit kundër Trafikimit të Personave u zhvillua një takim me disa nga të mbijetuarat e trafikimit, të cilat ndanë rrëfime të forcës, guximit dhe shpresës.

Përmes historive të tyre u sollën në vëmendje jo vetëm sfidat e kaluara, por edhe mundësitë e reja që hapen kur viktimat marrin mbështetje dhe shansin për një jetë të sigurt.

Ky takim ishte një thirrje për më shumë solidaritet, angazhim institucional dhe shoqëror, në mënyrë që çdo viktimë e trafikimit të gjejë drejtësi, siguri dhe dinjitet.

Pas tre vitesh në shtëpinë tonë A u birësua nga Ana dhe Filipi, dy prindër që kaluan Adriatikun për t'i dhuruar asaj një familje të vërtetë dhe dashuri të pakushtëzuar. Sot A nis një kapitull të ri, duke u rritur mes kujdesit dhe përkujdesjes prindërore që çdo fëmijë meriton.

Çdo fëmijë ka të drejtë për një familje dhe për një të ardhme të sigurt e të mbushur me dashuri.



Në kuadër të projektit “Gjithëpërfshirje në vendin e punës” u nënshkrua një marrëveshje mes IPSED dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë.

Ky projekt synon të fuqizojë personat me aftësi të kufizuara për një karrierë të qëndrueshme, të rrisë angazhimin e punëdhënësve si dhe të përmirësojë kapacitetet e aktorëve lokalë për një përfshirje më të gjerë në tregun e punës.



Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al